

**RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCARE
TË KOMUNËS SË SKENDERAJT
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2015**

Prishtinë, qershor 2016

Grant Thornton LLC ka kryer auditimin e Pasqyrave Vjetore Financiare të Komunës së Skenderajt ("Komuna") për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, në emër të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm ("ZAP").

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen Auditime të Rregullsisë dhe të Performancës. Auditori i Përgjithshëm është kreu i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm janë të pavarur dhe çertifikon për çdo vit Pasqyrat Vjetore Financiare për rreth 90 subjekte, ndërsa mund të ndërmarr edhe forma të tjera të auditimit.

Misioni i ZAP-it është që të "Kontribuojë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratën publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e auditimit në sektorin publik të pranuar ndërkombëtarisht dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesave të taksapaguesve dhe palëve të tjera të interesit në rritjen e llogaridhënies publike. "

Raportet e nxjerra nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi ato ofrojnë bazë për t'i kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

TABELA E PËRMBAJTJES

| | |
|---|----|
| Përmbledhje e përgjithshme..... | 3 |
| 1 Pasqyrat Vjetore Financiare dhe Obligimet e tjera për Raportimin të Jashtëm ... | 6 |
| 2 Qeverisja..... | 13 |
| 3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli..... | 20 |
| Shtojca I: Qasja dhe Metodologjia e Auditimit..... | 35 |
| Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara | 37 |
| Shtojca III: Rekomandimet e Vitit Paraprak | 39 |
| Shtojca IV: Përgjigja e Menaxhmentit ndaj të Gjeturave Tona të Auditimit | 43 |
| Shtojca V: Pasqyrat Vjetore Financiare | 51 |

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje


Ne, Grant Thornton LLC kemi kryer auditimin e Pasqyrave Vjetore Financiare të Komunës së Skenderajt ("Komuna") për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, në emër të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm ("ZAP").

Ky raport përmbledh gjetjet kryesore nga auditimi i Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2015 të Komunës së Skenderajt të shpalosura në Raportin e Auditorit të Pavarur të lëshuar nga Grant Thornton LLC.

Ne do të donim të falënderojmë Kryetarin e Komunës dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2015 u bë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat që ne menduam se janë të nevojshme për të dhënë një opinion lidhur me pasqyrat financiare.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Niveli i punës së kryer nga ne, për të përfunduar auditimin për vitin 2015 është pasqyrim i drejtpërdrejtë i cilësisë së kontrollit të brendshëm i zbatuar nga menaxhmenti.


Opinion

Shtojca II shpjegon llojet e ndryshme të Opinioneve të aplikuara.

Opinionin ynë i auditimit, i prezantuar në faqet nga 8 deri në 10 të këtij Raporti është i kualifikuar për shkak të kufizimit të fushëveprimit në lidhje me balancën e pasurive kapitale jo-financiare me vlerë mbi 1,000 euro, kufizim të fushëveprimit në lidhje me balancën e pasurive jokatitale me vlerë nën 1,000 euro, , dhe paragrafin e theksimit të çështjes lidhur me mospajtueshmërinë me kërkesat e Rregullores Financiare MF-Nr. 01/2013.

Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:



Eksistojnë mangësi në lidhje me kontrollet për përgatitjen e Raportit Financiar, procedurat e prokurimit, menaxhimin e llogarive të arkëtueshme, menaxhimin e llogarive të pagueshme, menaxhimin e të hyrave, aplikimin e procedurave të shpenzimeve dhe menaxhimin e dosjeve të personelit.



Kryetari duhet të rishikojë masat ekzistuese të qeverisjes së përgjithshme dhe cilësinë e raportimit të brendshëm të Komunës (shih seksionin 3).

Ekzistojnë dobësi në kontrole për të konfirmuar plotësinë, saktësinë dhe pronësinë e pasurive.



Kryetari duhet të sigurojë që regjistri i pasurive kapitale dhe jo-kapitale përmban informacion të plotë dhe të saktë si dhe inventarizimi i pasurive është kryer në bazë të legjislacionit në fuqi. (shih seksionin 3.7.1).

Përgjigja e Kryetarit – për auditimin e vitit 2015

Të gjeturat e hollësishme të auditimit dhe konkluzionet në këtë raport janë marrë në konsideratë nga Kryetari. Përgjigjet e Kryetarit me të cilat ne nuk kemi arritur një qëndrim të përbashkët janë të detajuara në Shtojcën IV.

Ne e konsiderojmë si të kryer faktin që Kryetari:

- Do ta shqyrtoj raportin e auditimit në Asamblenë Komunale; dhe
- Deri në fund të muajit janar 2017, të iniciojë diskutimet në Asamblenë Komunale lidhur me implementimin e Planit të Veprimit për rekomandimet e auditimit, para se PVF 2016 të jenë dorëzuar në Ministrinë e Financave.

1 Pasqyrat Vjetore Financiare dhe Obligimet tjera për Raportim të Jashtëm

1.1 Përshkrimi

Auditimi ynë i PVF merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe saktësinë e informatave të regjistruara në pasqyrat financiare. Gjithashtu, ne marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata për prezantimin e PVF-ve përfshin një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PVF-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.2 Opinioni i auditimit



Raporti i Auditorit të Pavarur

Grant Thornton LLC
Rr. Rexhep Mala 18
10 000 Pristina
Republic of Kosovo

T +381 38 247 771
+381 38 247 801
F +381 38 247 802
www.granthornton-ks.com

Drejtuar Kryetarit të Komunës së Skenderajt

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Komunës së Skenderajt ("Komuna"), të cilat përbëhen nga Pasqyra e Pranimeve dhe Pagesave në Para të Gatshme dhe Pasqyra e Realizimit të Buxhetit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe informatave tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP) për "Raportimin Financiar Bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme", dhe me Rregulloren MF -Nr. 03/2013 "Për Pasqyrat Vjetore Financiare të Organizatave Buxhetore" dhe kontrollin e tilla të brendshme, që menaxhmenti përcakton nëse është e nevojshme përgatitja e pasqyrave financiare pa keqdeklarime materiale çoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Përgjegjësia e Auditorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Këto standarde kërkojnë që ne të jemi në pajtueshmëri me kërkesat etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare janë pa keqdeklarime materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe shpalosjeve në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshirë vlerësimin e risqeve të keqdeklarimeve materiale në pasqyrat financiare, çoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve, auditori merr parasysh kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare të Komunës në mënyrë që të hartoj procedurat e auditimit që janë të duhura për rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin e duhur të politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të përgjithshëm të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që dëshmitë e e auditimit që ne i kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për të siguruar një bazë për opinionin tonë të kualifikuar të auditimit.

Baza për opinion të kualifikuar

- i. Të dhënat lidhur me pasuritë kapitale jo-financiare me vlerë mbi 1,000 euro në pronësi të Komunës janë shpalosur në pasqyrat financiare. Megjithatë, ka shumë mangësi dhe pasiguri që ndikojnë në raportimin financiar të Komunës për pasuritë kapitale jo-financiare me vlerë mbi 1,000 euro si në vijim:
- Regjistri i pasurisë në lidhje me pasuritë kapitale jo-financiare nuk është i plotë dhe i vlefshëm. Për më tepër, Komuna nuk ka regjistruar si duhet pasuritë kapitale jo-financiare me vlerë mbi 1,000 euro, në Sistemin Informativ të Menaxhimit të Financave të Kosovës. Në regjistrin e mjeteve themelore është regjistruar shuma prej 3,885 mijë euro duke iu referuar pagesave të bëra nga agjencitë e ndryshme qeveritare dhe donatorët në vitet paraprake dhe në vitin aktual të cilat nuk ishin të dokumentuara sipas kërkesave të nenit 12 dhe 13 të rregullores MF Nr.02/2013.
 - Për më tepër, Komuna nuk ka marrë një raport zyrtar të detajuar nga agjencitë qeveritare që ka të bëjë me investimet që janë bërë në Komunë. Si pasojë e kësaj, ne nuk ishim në gjendje të arrijmë siguri të arsyeshme se të gjitha investimet e këtij viti dhe të viteve të kaluara janë regjistruar dhe prezantuar në mënyrë të duhur në shënimin 30 "Përmbledhje e pasurive kapitale jo-financiare me vlerë mbi 1,000 euro në posedim të Organizatës Buxhetore "dhe se investimet në fjalë janë në pronësi të Komunës.
 - Për më tepër, për shkak të mangësive në regjistrin e pasurisë kapitale jo-financiare për pasuritë me vlerë mbi 1,000 euro, ne nuk ishim në gjendje për të përcaktuar nëse zhvlerësimi i llogaritur nga sistemi, përkatësisht, vlera neto në libra e prezantuar në shënim është e saktë.
 - Komuna nuk ka kryer vlerësimin e pasurive jo-financiare të saj gjatë vitit 2015, siç kërkohet me rregulloren MF-Nr.02 / 2013 për menaxhimin e pasurive jofinanciare të organizatës buxhetore.
 - Komuna nuk ka qenë në gjendje të na ofroj raportin e inventarizimit ashtu siç kërkohet me nenin 19 të Rregullores Nr.02/2013 për menaxhimin e pasurive jofinanciare të organizatës buxhetore.

Për shkak të natyrës së regjistrimeve dhe mangësive të tjera të përshkruara në paragrafët më sipër, ne nuk ishim në gjendje të kënaqemi me shpalosjet, ekzistencën, plotësinë, pronësinë dhe saktësinë e pasurive kapitale jo-financiare të Komunës me vlerë mbi 1,000 euro më 31 dhjetor 2015.

- ii. Në shënimin 31 të pasqyrave vjetore financiare janë prezantuar pasuritë jo -kapitale me vlerë nën 1,000 euro, në shumën prej 1,289 mijë euro. Komuna nuk e ka përdorur sistemin "E-Pasuria" për të regjistruar të gjitha pasuritë jo - kapitale me vlerë nën 1,000 euro. Prandaj ne nuk ishim në gjendje për të barazuar shumën e prezantuar në këtë sistem me shumën e prezantuar në shënimin 31 "Përmbledhja e pasurive jo-kapitale me vlerë nën 1,000 euro dhe jetë të dobishme më shumë se një vit". Për më tepër, për shkak të mangësive në regjistrin e pasurisë ne nuk ishim në gjendje për të llogaritur zhvlerësimin për këto pasuri, prandaj ne nuk mund të përcaktojmë nëse vlera neto në libra e këtyre pasurive të prezantuara në shënimin 31 është e saktë.

Kështu që, ne nuk ishim në gjendje të kënaqemi në lidhje me ekzistencën, plotësinë dhe saktësinë e pasurive jokapitale me vlerë nën 1000 euro.

Opinion i kualifikuar

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimeve të mundshme të çështjeve të referuara në paragrafët i dhe ii siç është paraqitur në paragrafin Baza për Opinion të Kualifikuar, pasqyrat financiare të Komunës për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2015 janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me SNKSP "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Bazuar në Paranë e Gatshme" dhe me Rregulloren MF - Nr 03/2013 "për Pasqyrat Vjetore Financiare të Organizatave Buxhetore".

Theksim i Çështjes

Ne tërheqim vëmendjen në shënimin 28 "Pasqyra e faturave të papaguara (detyrimet) e Organizatës Buxhetore" ", ku nga faturat në vlerë prej 195 mijë euro, pjesa më e madhe janë fatura të papaguara për më shumë se 30 ditë, dhe kjo nuk është në përputhje me kërkesat e Rregullores Financiare MF-Nr . 01/2013 " Shpenzimi i parasë publike". Opinioni ynë nuk është i kualifikuar për këtë pikë.

Çështje tjetër

Pasqyrat financiare të Komunës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014 janë audituar nga një auditor tjetër, i cili ka shprehur një opinion të kualifikuar dhe theksim të çështjes të këtyre pasqyrave financiare më 23 qershor 2015, për shkak të mospajtueshmërisë në lidhje me prezantimin e të hyrave dhe granteve në pasqyrën e realizimit të buxhetit, kufizimit në fushëveprim në lidhje me balancën e pasurive kapitale jo-financiare me vlerë mbi 1,000 euro, kufizimit në fushëveprim në lidhje me balancën e pasurive jo-kapitale me vlerë nën 1,000 euro dhe kufizimit në fushëveprim në lidhje me balancat krahasuese për pranimet tjera –pagesat nga palët e treta si dhe paragrafin e theksimit të çështjes lidhur me mospajtueshmërinë me kërkesat e Rregullores Financiare MF-Nr. 01/2013" Shpenzimi i parasë publike".

Grant Thornton LLC

Prishtinë,
22 qershor 2016

1.3 Risqet domethënëse në Pasqyrat Vjetore Financiare

Përshkrimi

Në Memon tonë të Auditimit të datës 10 dhjetor 2015 janë identifikuar risqe domethënëse për Pasqyrat Vjetore Financiare që kanë të bëjnë me plotësinë dhe pronësinë e pasurisë. Risqet e sipërpërmendura janë materializuar dhe rezultuan në opinion të modifikuar. Gjatë kryerjes së auditimit final kemi identifikuar risqe të rëndësishme në lidhje me përgatitjen e pasqyrave financiare të cilat kanë rezultuar në modifikimin e opinionit.

Risqet e keqdeklarimeve materiale që ne i kemi identifikuar në lidhje me plotësinë dhe pronësinë e pasurisë si dhe përgatitjen e pasqyrave vjetore financiare kanë ndodhur për shkak se menaxhmenti nuk ka marrë asnjë veprim për të adresuar risqet e theksuara.

1.4 Pajtueshmëria me kërkesat për PVF dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna duhet të jetë në pajtim me kornizën e caktuar raportuese për raportim dhe kërkesat e tjera. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren Financiare Nr.03/2013;
- Kërkesat e LMFP nr.03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime)
- Afatin e dorëzimit të raporteve tek Ministria e Financave;
- Kërkesat për nënshkrim të PFV nga ZKA("Kryetari") dhe Zyrtari Kryesor Financiar;
- Kërkesat për të përgatitur PFV në kopje fizike dhe elektronike;
- Dorëzimin e raporteve tremujore në Kuvendin e Komunës dhe Ministri të Financave;
- Rregulloren Financiare MF-Nr.02/2013 "Raportimi i obligimeve nga Organizatat Buxhetore"
- Raportet operative (treguesit e performancës);
- Raporti për veprimet e propozuara dhe të ndërmarra për gjetjet dhe rekomandimet e vitit të kaluar nga Auditori i Jashtëm; dhe
- Paraqitja e PFV në gjuhën shqipe dhe serbe.

Nga auditimi ynë ne kemi vërejtur se nga kërkesat e mësipërme, Komuna nuk është në përputhje me kërkesat e Rregullores Financiare MF-Nr.02 / 2013 "Për raportimin e borxheve nga ana e organizatave buxhetore", si dhe disa aspekte tjera të Pasqyrave Vjetore Financiare , si vijon:

-
- Në shënimin 28 "Pasqyra e faturave (obligimeve) të papaguara të Organizatës Buxhetore" janë përfshirë edhe detyrimet në shumën prej 27 mijë euro të cilat janë pas datës 31 dhjetor 2015.

Në Shënimin 29 "Detyrimet kontingjente" nuk janë të prezantuara të gjitha çështjet gjyqësore më 31 dhjetor 2015.

- Burimi kryesor dhe i besueshëm i informacionit për përgatitjen e pasqyrave financiare është Free Balance, i cili nuk përdoret për të regjistruar dhe raportuar të gjitha shpalosjet të cilat nuk raportohen sipas Kontabilitetit të Bazuar në Paranë e Gatshme. Këto shpalosje përfshijnë të hyrat nga gjobat, pagesat nga palët e treta, të arkëtueshmet, detyrimet kontingjente dhe të papaguara;

Duke marrë parasysh atë që u shpalos më lartë dhe në opinionin e auditimit, deklarata e bërë nga Kryetari i Komunës dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur i janë dorëzuar pasqyrat vjetore financiare Qeverisë, mund të konsiderohet e mangët për shkak të dobësive materiale të identifikuar dhe çështjeve të tjera të shpalosura në këtë raport.

1.5 Rekomandimet

Rekomandimi përfshinë të gjitha çështjet e ngritura në nëntitullin "Pasqyrat Vjetore Financiare dhe Obligimet tjera për Raportim të Jashtëm"

Rekomandimi 1 **Prioriteti i lartë** - Kryetari duhet të sigurojë që është bërë një analizë për të përcaktuar arsyet për kualifikimin e opinionit të auditimit dhe paragrafin e theksimit të çështjes. Duhet të ndërmerret veprimi për të adresuar dobësitë e rëndësishme në një mënyrë sistematike dhe pragmatike për të zvogëluar dobësitë e shpalosura në paragrafin e bazës për opinion të kualifikuar.

Rekomandimi 2 **Prioriteti i lartë** - Kryetari duhet të marrë masat e duhura për të siguruar pajtueshmëri rregullative të plotë të procesit të përgatitjes së pasqyrave vjetore financiare (PVF). Deklarata e bërë nga Kryetari i Komunës dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PVF-të të dorëzohen në Qeveri duhet të nënshkruhet vetëm pas një shqyrtimi gjithëpërfshirës të menaxhmentit i ndërmarrë për përmbajtjen dhe saktësinë e PVF.

2 Qeverisja

2.1 Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për Komunën që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset dhe kontrollat ekzistuese. Për më tepër, lista kontrolluese e vetëvlerësimit që duhet të plotësohet nga Komuna siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes.

Ne gjithashtu konsiderojmë se fushat e aranzhimeve të qeverisjes që kërkojnë përmirësime të rëndësishme janë të tilla si vlerësimi i riskut, Sistemi të Auditimit të Brendshëm dhe proceset e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

2.2 Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Qasja jonë e auditimit është fokusuar në të kuptuarit dhe vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti për të siguruar qeverisje efektive dhe llogaridhënese, menaxhim financiar dhe kontroll. Ne vlerësojmë nëse kontrollat janë të hartuara mirë, janë zbatuar sipas planit apo funksionojnë në mënyrë efektive. Për ta bërë këtë kërkohet vlerësim i strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti. Ne gjithashtu marrim parasysh çështje të veçanta të tilla si formulari i vetëvlerësimit të MFK dhe vlerësimi i riskut. Pjesa për menaxhimin financiar dhe kontrollin është paraqitur në seksionin 3 të këtij raporti.

Ne konsiderojmë se Komuna ka nevojë për përmirësime në adresimin e rekomandimeve nga viti paraprak, plotësimin e listës së kontrollit të vetëvlerësimit, proceset e menaxhimit të riskut, për të përmirësuar raportimin e menaxhmentit dhe efektivitetin e sistemit të auditimit të brendshëm.

2.3 Rekomandimet e Vitit Paraprak

Raporti i auditimit të vitit paraprak ka rezultuar në 18 të rekomandime të dhëna. Edhe pse Komuna ka zbatuar kërkesën për të ofruar një plan veprimi pas marrjes së raportit të auditimit të ZAP 2014 kemi vërejtur se rekomandimet janë zbatuar vetëm pjesërisht. Në planin e veprimit janë prezantuar të gjeturat, komentet e menaxhmentit dhe hapat që duhet të ndërmerren për zbatimin e rekomandimeve. Duhet të theksohet se plani i veprimit është i përgjithshëm dhe procesi i zbatimit nuk është e specifikuar në mënyrë adekuate. Për më tepër, nuk ka dëshmi të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve. Duhet të përmendet se raporti paraprak i auditimit të vitit nuk u diskutua në kuvend. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe se si janë adresuar, shih Shtojcën III.

Rekomandime

Çështja 1 - Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioriteti i lartë

Gjetje Siq është shpalosur në shtojcën III, vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit paraprak janë zbatuar për shkak se Komuna nuk ka ndjekur një proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar zbatimin e rekomandimeve.

Risku Zbatimi i pamjaftueshëm i rekomandimeve nga viti i kaluar çon drejt: regjistrimit jo të plotë të pasurisë; mospajtueshmëri me kërkesat e raportimit; menaxhimi i dobët i të hyrave për shkak të mungesës së evidencave dhe të raportimit të brendshëm; Mungesë e informacionit të duhur mbi PVF; Përfitimi i kufizuar nga puna e Auditimit të Brendshëm; Trajtimi jo i duhur i shpalosjes së llogarive të arkëtueshme; Trajtimi jo i duhur i shpalosjes të borxhit.

Rekomandimi 3 Kryetari i Komunës duhet të rishikoj Planin e Veprimit për adresimin e rekomandimeve të vitit 2014. Ky plan duhet të përcaktojë një kornizë të arsyeshme kohore të zbatimit, personel përgjegjës dhe modalitet në aplikim, duke u fokusuar fillimisht në fushat e rëndësisë së lartë, dmth. ku janë identifikuar dobësi domethënëse. Progresi i planit duhet të monitorohet direkt nga Kryetari.

2.4 Lista kontrolluese e vetëvlerësimit nga MF

Ministria e Financave ka hartuar një listë të detajuar të vetë-vlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur rregullimin efektiv të qeverisjes. Komuna ka plotësuar listën e vetëvlerësimit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015. Ministria e Financave ka theksuar se korniza ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin që ka hyrë në fuqi kohët e fundit dhe disa aspekte të MFK përbëjnë risi në Kosovë, dhe se një rezultat i lartë vetë-vlerësimi, që do të thotë se nuk ka përmirësime të nevojshme të sistemit, do të ishte joreal. Për më tepër, Ministria e Financave thekson që pyetësi duhet të plotësohet me vërtetësi dhe përgjigjet duhet të jenë objektive dhe të dokumentuara.

Çështja 2 - Lista kontrolluese e vetëvlerësimit - Prioriteti i lartë

Gjetje

Ne kemi shqyrtuar përgjigje të shumta për pyetjet e pesë komponentëve kryesor të pyetësit të vetë-vlerësimit; Mjedisi i kontrollit, menaxhimi i riskut, aktiviteti i kontrollit, Informimi dhe komunikimi, dhe monitorimi. Nga shqyrtimi ynë janë identifikuar çështjet si më poshtë:

Mjedisi i Kontrollit

Komuna ka vlerësuar veten me notën 2.76 nga 3 në këtë komponent. Nga shqyrtimi ynë i pyetjeve ne kemi identifikuar se përgjigjet e shumta nuk ishin të përshtatshme dhe nuk ishin të dokumentuara ashtu siç kërkohet nga pyetësi.

Menaxhimi i Riskut

Komuna ka vlerësuar veten me notën 2.08 nga 3 në këtë komponent. Nga shqyrtimi ynë i pyetjeve ne kemi identifikuar se përgjigjet e shumta nuk ishin të duhura dhe të dokumentuara ashtu siç kërkohet nga pyetësi.

Aktiviteti i Kontrollit

Komuna ka vlerësuar veten me notën 2.64 nga 3 në këtë komponent. Nga shqyrtimi ynë i pyetjeve ne kemi identifikuar se përgjigjet e shumta nuk ishin të duhura dhe të dokumentuara ashtu siç kërkohet nga pyetësi.

Informimi dhe Komunikimi

Komuna ka vlerësuar veten me notën 2.64 nga 3 në këtë komponent. Nga shqyrtimi ynë i pyetjeve ne kemi identifikuar se përgjigjet e shumta nuk ishin të duhura dhe të dokumentuara ashtu siç kërkohet nga pyetësi.

Monitorimi

Komuna ka vlerësuar veten me notën 2.44 nga 3 në këtë komponent. Nga shqyrtimi ynë i pyetjeve ne kemi identifikuar se përgjigjet e shumta nuk ishin të duhura dhe të dokumentuara ashtu siç kërkohet nga pyetësi.

Risku

Aranzhimet e dobëta të qeverisjes zvogëlojnë proceset strategjike dhe operacionale dhe ulin cilësinë e shërbimeve të ofruara për qytetarët përmes aktiviteteve joefikase dhe joefektive.

Rekomandimi 4

Kryetari duhet të sigurojë që lista kontrolluese e vetë-vlerësimit është plotësuar me objektivitet dhe është dokumentuar në mënyrë që të identifikoj dhe zvogëloj dobësitë në mënyrë të përshtatshme, siç kërkohet nga Ministria e Financave e Republikës së Kosovës.

2.5 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të qeverisjes është bazuar në planifikimin e auditimit, duke marrë parasysh mjedisin ligjor brenda të cilit operon Komuna dhe sfidat me të cilat ajo përballet.

2.5.1 Aranzhimet e llogaridhënies

Komuna ka procese formale të llogaridhënies dhe të raportimit, por ka mungesë në efikasitet dhe efektivitet.

Çështja 3 – Proceset e llogaridhënies- Prioriteti i lartë

Gjetje Proceset formale të llogaridhënies dhe të raportimit të Komunës kanë nevojë për tu ngritur dhe për tu përmirësuar.

Risku Mungesa e proceseve të llogaridhënies dhe të raportimit mund të rezultojnë në reduktimin e efektivitetit të menaxhimit financiar brenda Komunës. Për më tepër, kjo rezulton në dobësi në ndërtimin dhe realizimin e buxhetit dhe zvogëlon aftësinë e menaxhmentit për të reaguar ndaj sfidave financiare me kohë.

Rekomandimi 5 Kryetari i Komunës duhet të sigurojë një rishikim të kërkesave ekzistuese të llogaridhënies dhe raportimit të drejtorive komunale për të siguruar aranzhime të përmirësuar, për të arritur objektivat specifike gjatë një viti.

2.5.2 Menaxhimi i Riskut

Të gjitha organizatat buxhetore pritet të zbatojnë vlerësimin e riskut siç kërkohet nga rregulloret dhe udhëzimet.

Çështja 4 – Moszbatimi i kërkesave për menaxhimin e riskut – Prioriteti i lartë

Gjetje Procedurat dhe sistemet komunale të menaxhimit të riskut nuk janë ende funksionale.

Risku Menaxhimi i riskut përfshin përcaktimin para kohe të asaj se çfarë mund të ndodhë që nuk dëshirohet të ndodhë. Kështu, mungesa e menaxhimit efektiv të riskut do të zvogëlojë cilësinë e shërbimit për qytetarët për shkak të çështjeve të brendshme dhe të jashtme që kanë ndikim dhe që nuk trajtohen në kohën e duhur.

Rekomandimi 6 Kryetari duhet të sigurojë që procedurat dhe sistemet e menaxhimit të riskut janë krijuar dhe janë funksionale. Për më tepër, përgjegjësia për menaxhimin e riskut është deleguar direkt tek një drejtor përkatës që të sigurojë raportimin mujor mbi zbatimin e kërkesave në këtë fushë dhe të sigurojë se risqet janë duke u menaxhuar.

2.5.3 Raportimi Menaxherial

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare janë duke funksionuar si duhet. Është e rëndësishme që ata të përfshijnë të drejtën e raportimit të menaxhmentit për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Çështja 5 – Dobësi në Kontrollin Menaxherial – Prioriteti i lartë

| | |
|----------------------|--|
| Gjetje | Rishikimi që ne i kemi bërë kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin kryesor financiar komunal ka theksuar dobësitë në kontrollet e nivelit të lartë. Si të tilla, aranzhimet e qeverisjes kërkojnë forcim, në veçanti në lidhje me kontrollet në: përgatitjen e Raportit Financiar (nëntë muaj dhe vjetor), inventarizimin, vlerësimin dhe prezantimin e pasurisë kapitale, procedurat e prokurimit, menaxhimin e llogarive të arkëtueshme, menaxhimin e llogarive të pagueshme, menaxhimin e të hyrave, aplikimin i procedurave të shpenzimeve dhe menaxhimin e dosjeve të personelit. |
| Risku | Cilësia e dobët e raportimit financiar tek menaxhmenti i lartë redukton aftësinë e menaxhmentit për të reaguar në kohë dhe në mënyrë aktive për të menaxhuar aktivitetet e Komunës, dhe dëmton kontrollin efektiv të buxhetit. |
| Rekomandimi 7 | Kryetari i Komunës duhet të rishikojë masat ekzistuese të qeverisjes së përgjithshme dhe cilësinë e raportimit të brendshëm të Komunës. Kërkesat pazbatuara duhet të adresohen deri në fund të vitit 2016. Cilësia e raportimit dhe mbikëqyrjes buxhetore duhet të shqyrtohet në mënyrë kritike dhe sistematike për të siguruar arritjen e objektivave të Komunës. |

2.6 Sistemi i Auditimit të Brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm përbëhet nga një auditor i cili ka planifikuar 4 aktivitete për vitin 2015. Deri më 31 dhjetor 2015 tek ne janë prezantuar 4 shqyrtime të përfunduara dhe 1 shqyrtim ad hok. Ne duhet të shtojmë se në dy raporte, periudha e mbuluar nga auditori i brendshëm ka qenë për vitin e përfunduar 31 dhjetor 2014 respektivisht, tremujorin e parë të vitit 2015. Edhe pse njësia e auditimit të brendshëm ekziston, performanca e saj është e ulët.

Çështja 6 – Funksionimi i Njesisë së Auditimit – Prioriteti i lartë

- Gjetje** Njësia e Auditimit të Brendshëm përbëhet nga një auditore që njëkohësisht është edhe drejtoreshë e njesisë. Departamenti ekzistues i auditimit të brendshëm ka mungesë të burimeve njerëzore. Sipas Udhëzimit Administrativ 23/2009 Organizatat Buxhetore me buxhet më të madh se 5,000 mijë euro duhet të angazhojnë së paku tre auditorë në Departamentin e Auditimit të Brendshëm. Mosangazhimi i stafit në departamentin e auditimit ka ndikuar në punën e njesisë së auditimit e cila ka kryer vetëm 4 aktivitete gjatë vitit 2015.
- Risku** Sistemi i auditimit të brendshëm është një pjesë kyçe e kontrollit të brendshëm dhe si i tillë duhet të ofrojë siguri mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme. Mungesa e kapacitetit në Departamentin e Auditimit të Brendshëm zvogëlon sigurinë që ajo ofron në lidhje me funksionimin e sistemeve financiare të cilat mund të rezultojnë në humbje financiare për Komunën.
- Rekomandimi 8** Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që Departamenti i Auditimit të Brendshëm ka burime të përshtatshme dhe të mjaftueshme njerëzore. Për më tepër, Kryetari duhet të sigurojë që aktiviteti i ardhshëm i AB duhet të udhëhiqet në drejtim të zhvillimit dhe zbatimit të strategjisë së auditimit të bazuar në risk. Gjithashtu, në mënyrë që përfitimet të jenë të dukshme, Kryetari duhet të marrë masa për zbatimin e rekomandimeve të AB brenda Komunës.

3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

3.1 Hyrje

Qasja jonë e auditimit është fokusuar në të kuptuarit dhe vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti për të siguruar menaxhim financiar dhe kontroll efektiv. Ne vlerësojmë nëse kontrollet janë të hartuara mirë, janë zbatuar sipas planit apo funksionojnë në mënyrë efektive. Për ta bërë këtë, kërkohet vlerësim i strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti. Ne marrim parasysh çështje të veçanta të tilla si lista kontrolluese e vetëvlerësimit nga MFK dhe vlerësimi i riskut.

Ne kemi fokusuar rishikimin tonë të menaxhimit financiar dhe kontrollit në auditimin tonë për vitin e fundit në proceset dhe sistemet e tilla si;

- Menaxhimi dhe realizimi i buxhetit
- Procedurat e Prokurimit,
- Menaxhimi i të hyrave vetanake,
- Menaxhimi i të arkëtueshmeve,
- Menaxhimi i të pagueshmeve
- Menaxhimi i pasurisë jo-kapitale,
- Burimet njerëzore,

3.2 Konkluzioni për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin

Gjatë auditimit tonë ne kemi identifikuar dobësi në kontrollet menaxheriale të zbatuara në sistemin e qeverisjes së Komunës. Si i tillë, menaxhimi financiar dhe kontrolli kërkojnë forcim, në veçanti në lidhje me kontrollet në: përgatitjen e Pasqyrave Financiare (nëntë muaj dhe vjetore), plotësinë, saktësinë dhe pronësinë e pasurive kapitale, procedurat dhe planifikimin e prokurimit, menaxhimin e llogarive të arkëtueshme dhe të pagueshme, menaxhimin e të hyrave, zbatimin e procedurave të shpenzimeve dhe menaxhimin e dosjeve të personelit.

3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit

Ne kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për Komunën, shpenzimet e këtyre fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrat e arkëtuara siç janë paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1 Burimet e fondeve buxhetore - Realizimi ndaj buxhetit (në Euro)

| Përshkrimi | Buxheti Fillestar | Buxheti Final ¹ | Shpenzimi 2015 | Shpenzimi 2014 | Shpenzimi 2013 |
|---|-------------------|----------------------------|-------------------|-------------------|-------------------|
| Burimet e fondeve: | 11,090,999 | 11,636,860 | 11,235,296 | 11,279,619 | 11,252,000 |
| Granti i Qeverisë-Buxheti | 10,342,884 | 10,617,393 | 10,548,574 | 10,379,831 | 10,278,000 |
| Të bartura nga viti paraprak ² | - | 251,361 | 250,467 | 216,423 | - |
| Të hyrat vetanake ³ | 748,115 | 748,155 | 419,732 | 597,287 | 634,000 |
| Donacionet e Brendshme | - | 8,950 | 8,449 | 8,000 | - |
| Donacionet e Jashtme | - | 11,001 | 8,074 | 78,078 | 340,000 |

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 545,861 euro. Pjesa më e madhe e rritjes është rezultat i bartjes së të hyrave vetanake nga viti i kaluar në shumën prej 251,361 euro. Gjithashtu, Granti Qeveritar është rritur për 274,549 euro, pas rishikimit buxhetor në pajtim me vendimin e Qeverisë.

Në vitin 2015, Komuna ka shfrytëzuar 97% të buxhetit final ose 11,235,296 euro (2014: 96% ose 11,279,619 euro). Realizimi i buxhetit mbetet në nivel të kënaqshëm dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

¹ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi dhe i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

² Të hyrat vetanake të Komunës të pa shpenzuara në vitin e kaluar dhe të bartura në vitin aktual

³ Pranimet e përdorura nga Komuna për financimin e buxhetit të saj.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike – realizimi ndaj buxhetit (në euro)

| Përshkrimi | Buxheti Fillestar | Buxheti Final | 2015 Shpenzimi | 2014 Shpenzimi | 2013 Shpenzimi |
|--|-------------------|-------------------|-------------------|-------------------|-------------------|
| Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike: | 11,090,999 | 11,636,860 | 11,235,296 | 11,279,619 | 11,252,000 |
| Pagat dhe Mëditjet | 7,091,581 | 7,366,130 | 7,244,135 | 6,890,821 | 5,927,000 |
| Mallrat dhe Shërbimet | 932,838 | 958,094 | 870,692 | 921,811 | 1,170,000 |
| Shërbimet Komunale | 212,540 | 212,540 | 210,757 | 169,063 | 191,000 |
| Subvencionet dhe Transferet | 219,736 | 221,936 | 203,787 | 217,656 | 159,000 |
| Investimet Kapitale | 2,634,304 | 2,878,160 | 2,705,925 | 3,080,268 | 3,805,000 |

Realizmi lidhur me investimet kapitale është prezantuar në 94% që është realizim i kënaqshëm i buxhetit për këtë kategori. Komuna ka investuar kryesisht në infrastrukturën rrugore, ku rreth 70% e buxhetit të investimeve kapitale është investuar në këtë kategori.

Për më tepër, ka dallime në mes të planifikimit të prokurimit për investime kapitale dhe realizimit të këtyre investimeve. Kjo është sfida kryesore që duhet të adresohet nga menaxhmenti.

Lidhur me realizimin e shpenzimeve për kategorinë Paga dhe Mëditje, mund të shihet se buxheti është realizuar 98% në vitin 2015 (2014: 99%). Kjo është e pritshme pasi që projektimi i buxhetit për paga është mjaft i saktë.

Lidhur me realizimin e shpenzimeve për kategorinë Mallra dhe Shërbime, mund të shihet se realizimi i buxhetit është 91% i cili është më i lartë se vitin e kaluar (2014: 88%). Duhet theksuar se granti qeveritar për këtë kategori është shpenzuar 98%.

Buxheti për Subvencione dhe transfere është shpenzuar 92% (2014: 98%).

Tabela 3. Të hyrat vetanake të Komunës - realizimi ndaj buxhetit (në euro)

| Përshkrimi | Buxheti Fillestar | Buxheti Final | Pranimet 2015 | Pranimet 2014 | Pranimet 2013 |
|-------------------|-------------------|---------------|---------------|---------------|---------------|
| Të hyrat vetanake | 748,155 | 748,155 | 702,249 | 848,566 | 693,000 |

Për sa i përket të hyrave vetanake, mund të shihet se përqindja e realizimit është 94% deri në 31 dhjetor 2015, ose 146,317 euro më pak krahasuar me vitin 2014. Priorja e arkëtimit të të hyrave duhet të rritet nga viti në vit duke marrë parasysh mundësitë e Komunës. Të hyrat vetanake janë shfrytëzuar për shpenzime kapitale 17%, mallra dhe shërbime 23%, subvencione dhe transfere 18% dhe paga dhe mëditje 3%, ndërsa 40% e shumës është e bartur në vitin 2016.

Çështja 7 - Planifikimi i buxhetit - Prioriteti i lartë

- Gjetje** Komuna duhet bërë më tepër përpjekje në planifikimin dhe rritjen e arkëtimit të të hyrave vetanake. Për më tepër, ka dallime në mes të planifikimit të prokurimit për investime kapitale dhe realizimin e këtyre investimeve. Kjo është sfida kryesore që duhet të adresohet nga menaxhmenti.
- Risku** Planifikimi jo i duhur i buxhetit në lidhje me të hyrat vetanake si dhe devijimi i planifikimit të prokurimit ndaj realizimit do të rezultojë në një dështim për të përmbushur objektivat e Komunës.
- Rekomandimi 9** Kryetari i Komunës duhet të synojë që të rris performancën buxhetore lidhur me të hyrat vetanake dhe planifikimin efektiv për investime kapitale.

3.4 Prokurimi

Shuma e kontratave të nënshkruara përmes procedurave të prokurimit për periudhën e përfunduar më 31 dhjetor 2015 është 6,483 mijë euro. Kjo shumë përfshin Investime Kapitale dhe Mallra dhe Shërbime. Pjesa më e madhe kontratave për investime kapitale janë për një periudhë tre vjeçare.

Ka disa aspekte të procesit të prokurimit mbi të cilat kontrollet nuk janë zbatuar në mënyrë efektive. Ne kemi identifikuar raste kur prokurimet e kryera gjatë vitit nuk janë të harmonizuara me planin e prokurimit.

Auditimi ynë i menaxhimit të prokurimit ka identifikuar çështjet e mëposhtme:

Çështja 8 – Dobësitë sistematike në prokurim – Prioriteti i lartë

Gjetje

Gjatë auditimit të procedurave të prokurimit ne kemi identifikuar çështjet si në vijim:

Në trembëdhjetë dosje të prokurimit, Deklarata e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së Fondeve nuk është plotësuar në mënyrë të duhur. Kompletimi i DNPDF kërkohet me nenin 9 të Ligjit mbi Prokurimin Publik Nr. 04/L-042.

- Në dhjetë raste të prokurimit në vlerë të përgjithshme prej 2,333 mijë euro kemi vërejtur se, zotimet e mjeteve kanë qenë më pak se shuma e kontratave të nënshkruara dhe janë bërë pas nënshkrimit të kontratës. Kjo nuk është në përputhje me Ligjin e Prokurimit Publik 04 / L - 042 dhe Rregulloren Financiare Nr. 01/2013 "Ministria e Financave - Shpenzimi i Parasë Publike".
- Në pesë raste të procedurave të prokurimit në vlerë të përgjithshme prej 2,240 mijë euro polisa e sigurimit të ekzekutimit të tenderit nuk mbulon të gjithë periudhën e kontratës.
- Në një rast të prokurimit në vlerë 465 mijë euro ne kemi vërejtur se, nuk ka zotim të mjeteve.
- Në një rast të prokurimit në vlerë prej 389 mijë euro ne kemi vërejtur se faturat e lëshuara nga Operatori Ekonomik në vlerë të përgjithshme prej 50 mijë janë pa numër fiskal dhe pa adresë të plotë të shitësit, kjo nuk është në përputhje me Udhëzimin Administrativ nr.15/2010.
- Komuna ka nënshkruar një memorandum me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë të cilin Ministria zotohet të bëjë financim prej 600 mijë euro. Edhe pse kontrata është nënshkruar në vlerë më të vogël sesa shuma e mësipërme, Komuna i ka paguar operatorit ekonomik shumën prej 20,000 euro e cila sipas memorandumit duhet të ishte paguar nga Ministria.

-
- Në dy raste të prokurimit, në vlerën e përgjithshme të kontratave të nënshkruara prej 18 mijë euro, ne kemi vërejtur se nuk është respektuar neni 36 paragrafi 6 i Ligjit për Prokurim Publik 04 / L - 042 i cili thotë se: " data në të cilën kuotimet e çmimeve duhet të pranohen, duhet të jetë jo më pak se pesë (5) ditë nga data e dërgimit të kërkesës për kuotimin e çmimeve ".
 - Në një rast të prokurimit në vlerë prej 40 mijë euro, ne kemi vërejtur se nuk është respektuar neni 9 paragrafi 6 i Ligjit për Prokurim Publik 04 / L - 042 i cili thotë se: "nëse objektet e aktivitetit të prokurimit nuk janë përfshirë në planifikimin përfundimtar të autoritetit kontraktues i cili është dorëzuar në AQP sipas paragrafit 2 të nenit 8 të ligjit mbi prokurimin publik, ZKA do të dërgojë në AQP një kopje të Deklaratës përkatëse të Nevojave dhe Vendosshmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve së paku pesë (5) ditë para se Zyrtari Autorizues të autorizojë Zyrtarin e Prokurimit për iniciimin e aktivitetit përkatës të prokurimit".
 - Në një rast të prokurimit në vlerë prej 20 mijë euro, ne kemi identifikuar se sigurimi i ekzekutimit të tenderit nuk është në vlerën 10% të kontratës së nënshkruar siç specifikohet në nenin 63, paragrafi 2 të Ligjit për Prokurimin Publik 04 / L-42.
 - Në një rast të prokurimit në vlerë prej 505 mijë euro, ne kemi identifikuar se marrëveshja nuk ka datë të nënshkrimit dhe data e skadimit nuk është e cekur.
 - Në një rast të prokurimit në vlerë prej 45 mijë euro ne kemi vërejtur që në DNPDF , neni 3 "Rishikimi" nuk është nënshkruar nga Zyrtari Kryesor Financiar, kjo nuk është në përputhje me Ligjin për Prokurim Publik 04 / L - 042.
 - Në një rast të prokurimit në vlerë prej 45 mijë euro ne kemi vërejtur një mospërputhje në mes të faturës, fletdërgesës dhe raportit mbi pranimin e mallit për faturën në shumë prej 4 mijë euro. Përveç kësaj, në faturën në vlerë prej 8 mijë euro mungonte fletëdërgesa.
 - Në dy raste të procedurave të prokurimit që përbëjnë vlerën totale prej 16 mijë euro ne kemi vërejtur se mungonte garantimi i punës siç ishte e cekur në kontrata.
 - Në një rast të prokurimit në vlerë prej 10 mijë euro, kemi vërejtur se operatori ekonomik ka faturuar disa produkte dhe shërbime të cilat nuk janë në listën e ofertës së dosjes së tenderit.

| | |
|-----------------------|---|
| Risku | Mungesa e kontrolleve të efektshme në procedurat e prokurimit dhe moszotimi i mjeteve sipas kërkesave ligjore mund të çojnë në dështimin e kryerjes së pagesave ose kryerjen e pagesave të parregullta, vonesa në ofrimin e shërbimeve, si dhe kontratat mund të mos implementohen sipas standardeve të kërkuara. |
| Rekomandimi 10 | Kryetari duhet të identifikoj shkaqet rrënjësore të mangësive dhe të ndërmarrë masat e duhura për të siguruar se kërkesat e ligjit të prokurimit janë zbatuar plotësisht. |

3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit

3.5.1 Shpenzimet tjera

Nga mostra e testuar ne nuk kemi identifikuar mangësi në kategoritë mallra dhe shërbime dhe shërbime komunale. Ne nuk kemi rekomandime për këtë fushë.

3.5.2 Kompenzimet (Pagat dhe Mëditjet)

Shpenzimet për paga dhe mëditje janë paguar përmes sistemit të centralizuar të qeverisë (payroll-it). Kontrollat që operojnë në nivel lokal kanë të bëjnë me: a) autorizimin e listës së pagave; b) verifikimin e ndryshimeve të mundshme; dhe c) rishikimi i buxhetit për këtë kategori dhe barazimet me Thesarin. Mostra e selektuar për testim të personelit të Komunës së Skenderajt përbëhet prej: Administrate 8 dosje, Shendetesi: 3 dosje dhe Arsim 19 dosje. Ne kemi vërejtur mungesën e dokumentacionit siç përshkruhet më poshtë.

Çështja 9 – Të dhënat e Personelit – Prioriteti i mesëm

| | |
|---------------|--|
| Gjetje | <p>Gjatë auditimit të BNj, ne kemi identifikuar se dosjet e personelit nuk mbahen ashtu siç kërkohet me Rregulloren.Nr 03/2011 “Mbi dosjet dhe regjistrin qendror për shërbyesit civil” si dhe praktikat më të mira. Më poshtë janë identifikuar disa nga mangësit;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në 21 raste mungonte letra përcjellëse në dosje, - Në 17 raste mungonte raporti i hetimit gjyqësor; - Në 10 raste mungonte vërtetimi mjekësor; - Në 19 raste mungonte vlerësimi i aplikacioni i vlerësimit; - Në 19 raste mungonte vlerësimi i performancës në punë; - Në 10 raste mungonte forma e pushimit vjetor; - Në 19 raste mungonte vendimi për përcaktim si punonjës i rregullt, - Në 7 raste kontratat nuk ishin të nënshkruara nga punonjësit. - Pjesa më e madhe e listave të pagave nuk janë nënshkruar nga punonjësit. |
|---------------|--|

Gjatë testimit tonë të procesit të rekrutimit ne kemi identifikuar mospërputhjet si në vijim;

- Në tri raste të proceseve të rekrutimit, akt emërimi i kandidatit të përzgjedhur është nënshkruar para se të ketë përfunduar koha për ankesa nga ana e kandidatëve të pasuksesshëm, që nuk është në përputhje me nenin 43 të Rregullores Administrative Nr. 02/2010 mbi Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.
- Në dy raste kandidatët e përzgjedhur në pozita të caktuara nuk kanë përmbushur kriterin e përvojës në punë, që ishin kërkuar me shpalljen publike të Komunës.

Risku

Mungesa e dokumentacionit në dosjet e personelit dhe mungesa e nënshkrimeve dhe aprovimeve të kërkuara është në kundërshtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi. Gjithashtu mospërfillja e procedurave dhe kompletimit të dokumentacionit sipas rregullave mbi procesin e rekrutimit rrezikon që Komuna të punësojë punonjës të pa kualifikuar për pozitat përkatëse.

Rekomandimi 11

Kryetari duhet të sigurojë që Komuna të ndërmarrë hapa të mëtutjeshëm për përmirësimin e kontrolleve mbi dosjet e personelit dhe procesit të rekrutimit në mënyrë që dosjet të jenë të kompletuara dhe organizuara mirë si dhe procesi i rekrutimit të jetë në pajtueshmëri me rregulloret përkatëse, dhe të marrë masa në lidhje me nënshkrimin e listës së pagave.

3.5.3 Subvencionet dhe Transferet

Subvencionet dhe transferet gjatë vitit të përfunduar më 31 dhjetor 2015 kanë shumën 204 mijë euro, prej të cilave 76 mijë euro janë nga granti qeveritar, 126 mijë euro janë nga të hyrat vetanake dhe 2 mijë euro nga donacionet. Ne nuk kemi asnjë rekomandim në lidhje me këtë fushë.

3.6 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetanake)

Të hyrat vetanake të gjeneruara nga Komuna për vitin 2015 arrijnë vlerën 700 mijë euro. Kjo kategori përfshin të hyrat nga tatimi në pronë, taksat administrative dhe taksat rrugore, lejet e ndërtimit, etj.

Komuna ka një sërë kontrollesh për arkëtimin dhe raportimin e disa prej të hyrave të saj. Megjithatë, ekziston nevoja për përmirësim në disa procese, për të siguruar saktësinë dhe plotësinë e arkëtimit të të hyrave.

Çështja 10 - Të hyrat nga tatimi në pronë, nga qiraja dhe të hyrat tjera - Prioriteti i lartë

Gjetje

Komuna nuk ka verifikuar 1/3 e pronave ekzistuese të regjistruara. Për më tepër, sipas Ligjit mbi Tatimin në Pronë 03/L/2014 Neni 13, Paragrafi 3, Komuna duhet të rishikoj dhe të ndjekë vlerën e drejtë të pronave që janë në juridiksionin e saj çdo tre deri në pesë vjet. Një raport ne vitet e kaluara është pargaditur nga Komuna për përcaktimin e vlerës drejt të pronës së paluajtshme por i cili nuk është përgaditur në përputhshmeri më udhëzimin administrative nr 04/2011.

Një sistem automatik i faturimit ekziston vetëm për tatimin mbi pronë. Për kategoritë tjera të të hyrave për të cilat nevojitet sistemi i faturimit, nuk aplikohet. Në vend të kësaj, vetëm arkëtimet e parave nga të hyrat e tilla regjistrohen.

Komuna posedon softuer për regjistrimin dhe faturimin e shërbimeve për disa lloje të të hyrave të tilla si taksat e bizneseve, çmimet e të cilave nuk janë të integruara në sistem por futen në mënyrë manuale. Gjithashtu, të dhënat që mund të gjenerohen nuk janë të detajizuara për borxhet e secilës periudhë por japin vetëm shumën totale që pritet për tu arkëtuar, duke mos pasur një analizë për borxhet ndaj Komunës.

Ne kemi identifikuar se librat e regjistrimeve lidhur me të arkëtueshmet nga qiraja nuk janë të mbajtura në mënyrë të përshtatshme.

Ne kemi vërejtur se në rregulloren komunale për tarifa dhe ngarkesa shkruan se "nëse pagesa e qirasë nuk paguhet në kohën e duhur, obliguesit do të ngarkohen me kamatë prej 0.2%," sipas udhëzimit administrativ Komuna nuk ka të drejtë të caktoj kamatë dhe gjoba.

Të hyrat e faturuara për taksat e biznesit dhe qiratë gjatë vitit 2015 janë 64 mijë euro kurse balanca e të arkëtueshmeve deri 31 dhjetor 2015 është 389 mijë euro. Arkëtimi për periudhën është vetëm 20 mijë euro apo 8.9% e të arkëtueshmeve totale.

Ne kemi identifikuar një ndryshim në vlerën 3 mijë euro në të hyrat vetanake të prezantuara në pasqyrat financiare dhe pasqyrën e nxjerrë nga Free Balance.

Risku

Pa të dhëna të mjaftueshme, të detajuara dhe të sakta të debitorëve dhe raporteve mbi arkëtimet, Komuna nuk mund të përgatisë një buxhet të arsyeshëm dhe të saktë, e as të raportoj një normë të saktë për arkëtim, dhe të ndjekë arkëtimin e të hyrave vetanake në baza kohore. Më tej, niveli i ulët i arkëtimeve të të hyrave do të ndikoj në kapacitetin investiv të Komunës.

Kontrollet joadekuate dhe të pamjaftueshme lidhur me të hyrat dhe sistemin e faturimit rrisin rrezikun e ndryshimit të të dhënave dhe keqpërdorim të informacionit. Një sistem i tillë mund të çoj në faturim jo të plotë dhe të hyra jo të plota.

Mungesa e verifikimit për 1/3 e pronave mund të ndikojë që Komuna mos të ketë të dhëna të sakta e të plota të pronës së tatueshme aktuale, dhe si rezultat i kësaj ka një risk që të hyrat nga tatimi në pronë të ulen.

Rekomandimi 12

Ne rekomandojmë Kryetarin të ndërmarrë këta hapa:

Të përmirësojë sistemet e faturimit dhe të kontabilitetit në mënyrë që të sigurojë kontrole të sigurta, eficiente dhe efektive në faturim dhe të hyra. Përmirësimi i procedurave lidhur me sisteme të tilla do ti mundësonte menaxhmentit të monitoroj dhe të menaxhoj risqet e mëdha, dhe të siguroj që vendimet lidhur me buxhetimin, planifikimin dhe arkëtimin e të hyrave bëhen në mënyrë të duhur. Gjithashtu të siguroj që verifikimi dhe vlerësimi janë të plota dhe mirë të dokumentuara.

3.7 Pasuritë dhe Detyrimet

3.7.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Edhe pse Komuna ka ndërmarrë hapa për të përmirësuar raportimin për pasuritë e saj, ende ekzistojnë disa pasiguri dhe mangësi në lidhje me pasuritë e Komunës dhe rekomandimet e vitit paraprak janë adresuar vetëm pjesërisht.

Çështja 11 - Regjistri i pasurisë kapitale - Prioriteti i lartë

| | |
|-----------------------|--|
| Gjetje | Regjistri i pasurisë kapitale me vlerë mbi 1,000 euro nuk përmban datën përkatëse kur pasuria është blerë dhe vënë në përdorim. Ne nuk mund të përcaktojmë nëse zhvlerësimi i llogaritur nga sistemi, respektivisht vlera neto në libra, e pasurive të prezantuara në Shënimin 30 është e saktë. Për më tepër, në regjistrin e pasurisë fikse është regjistruar shuma prej 3,885 mijë euro duke iu referuar pagesave të bëra nga palët e treta në vitet mëparshme dhe vitin aktual të cilat nuk janë të dokumentuara sipas kërkesave të nenit 12 dhe 13 të rregullores MF Nr.02 / 2013. Për më tepër ka mungesë të dokumentacionit mbështetës të pronësisë të pasurive kapitale jo-financiare me vlerë mbi 1,000 euro. |
| Risku | Komuna nuk ka të dhëna të plota dhe të sakta rreth pasurive të saj. Kjo mund të çojë tek keqpërdorimi i pasurive dhe moszbulimi i keqpërdorimit me kohë. |
| Rekomandimi 13 | Kryetari duhet të sigurojë regjistrimin në kohë dhe të saktë të të gjitha pasurive në regjistrat përkatës, në përputhje me kërkesat e rregullores 02/2013. Ai gjithashtu duhet të sigurojë që pasuritë kapitale të cilat regjistrohen përmbajnë informacion të plotë, duke përfshirë datën kur pasuria është blerë dhe vënë në përdorim, në mënyrë që llogaritja e zhvlerësimit të mund të kryhet me saktësi. Si dhe të mabajë dokumentet përkatëse dhe të përcaktojë statusin e pronësisë. |

Çështja 12 - Inventarizimi i pasurisë kapitale- Prioriteti i lartë

| | |
|---------------|---|
| Gjetje | Komuna nuk ka bërë inventarizimin pasurisë kapitale me vlerë mbi 1,000 euromë 31 dhjetor 2015 siç kërkohet me Rregulloren MF-Nr. 02/2013 "Për menaxhimin e pasurive jo-financiare në Organizatat Buxhetore" e cila kërkon që "Organizatat buxhetore duhet të kontrollojnë së paku njëherë në vit pasurinë jo financiare për të vërtetuar dhe vlerësuar gjendjen faktike të pasurisë jo financiare". |
|---------------|---|

Risk Mos kryerja e inventarizimit të plotë të pasurisë siç kërkohet me rregullore, mund të rezultoj që Komuna të mos identifikoj gjendjen reale dhe faktike të pasurive të cilat mund të jenë të dëmtuara ose mungojnë plotësisht. Kjo mund të rezultojë në mbajtjen e pasurive të cilat nuk ekzistojnë në pasqyrat financiare, apo këto pasuri kanë vlerë më të ulët se ajo me të cilën mbahen në pasqyrat financiare.

Rekomandimi 14 Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që inventarizimi i pasurive kapitale jo-financiare është kryer në pajtim me Rregulloren në fuqi për pasuritë jo-financiare të Organizatave Buxhetore dhe të siguroj se inventarizimi bëhet në baza vjetore.

Çështja 13 - Shpalosja e pasurisë jo-kapitale me vlerë nën 1,000 euro - Prioriteti i lartë

Gjetje Në shënimin 31 të pasqyrave vjetore financiare janë prezantuar pasuritë jo kapitale me vlerë nën 1,000 euro, në shumën prej 1,289 mijë euro. Komuna nuk e ka përdorur sistemin "E-Pasuria" për të regjistruar të gjitha pasuritë jokapitale me vlerë nën 1,000 euro. Prandaj ne nuk ishim në gjendje për të barazuar shumën e prezantuar në këtë sistem me shumën e prezantuar në shënimin 31 "Përmbledhja e pasurive jo-kapitale me vlerë nën 1,000 euro dhe jetë të dobishme më shumë se një vit".

Për më tepër, për shkak të mungesës të informacionit mbështetës për pasuritë jo kapitale, ne nuk jemi në gjendje që të përcaktojmë efektin e zhvlerësimit për të gjithë balancën e pasurive jokapitale.

Risku Mungesa e dokumentacionit mbështetës për pasuritë jo-kapitale në pronësi të Organizatave Buxhetore mund të ndikojë në paraqitjen jo të saktë të informacionit në pasqyrat financiare. Kjo mund të rezultojë në mos paraqitjen e pasurive jo-kapitale në pasqyrat financiare me vlerën e drejtë ose në paraqitjen e pasurive që mund të jenë dëmtuar ose nuk ekzistojnë. Gjithashtu, paraqitja e pasurive jo-kapitale në vlerë bruto nuk është në përputhje me Rregulloren në fuqi për pasuritë jo-financiare të Organizatave Buxhetore.

Rekomandimi 15 Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që Komuna mban informacion të saktë dhe të plotë në lidhje me pasuritë jokapitale dhe të siguroj se pasuritë janë zhvlerësuar në bazë të rregullores në fuqi.

Çështja 14 - Mungesë e dokumentacionit të pronësisë dhe informacioneve për investimet e bëra nga palët e treta - Prioriteti i lartë

Gjetje Transferimi zyrtar i pronësisë për një pjesë të konsiderueshme të pasurisë të financuar nga palët e treta këtë vit dhe gjatë viteve të fundit të prezantuara në pasqyrat financiare si "Pagesat nga palët e treta", nuk është finalizuar ende.

Risku Mungesa e dokumentacionit mbështetës për pasuritë jo-kapitale në pronësi të Organizatës Buxhetore mund të ndikojë në prezantimin jo të saktë të informacionit në pasqyrat financiare.

Rekomandimi 16 Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj se Komuna është duke bërë përpjekje maksimale për sigurimin e të dhënave nga palët e treta, me theks të veçantë në ato palë që dihet se kanë kryer investime të rëndësishme në Komunë. Të dhënat e marra duhet të paraqiten si duhet në regjistrin e pasurive të Komunës. Praktika më e mirë do të kërkojë një barazim vjetor të bazës së të dhënave në mes të palëve të treta dhe Komunës për investime në Komunë për vitin përkatës.

3.7.2 Trajtimi i parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj

Çështja 15 - Depozitimi i parasë së gatshme- Prioriteti i lartë

Gjetje Ne kemi vërejtur se paratë e gatshme në zyrat e vendit nëpër bashkësitë lokale nuk janë depozituar cdo ditë në bankë. Parat e inkasuara në zyret e vendit në Bashkisë Lokale mbahen në arke, ndërsa në çdo fund jave dorëzohen në arken kryesore në Komunë ku edhe transferohen në banke nga arkatari kryesor së bashku me mjetet tjera të qendres. Kjo praktikë nuk është në përputhje me nenin 11 të rregullores 03/2010 e cila kërkon që: në fund të ditës parat e grumbulluara në arkat e OB-ve duhet të depozitohen në total për çdo lloj të të hyrave me fature përmbledhese të percaktuar me numrin identifikues UNIREF.

Risku Mungesa e depozitave të rregullta të parasë së gatshme në bankë nga ana e Komunës mund të rezultojë në shpërdorime të parave të gatshme dhe të gabimeve të paidentifikuara në raportimin e balancave të parasë dhe përveç kësaj, një praktikë e tillë nuk është në pajtueshmëri me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

Rekomandimi 17 Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se depozitat e përditshme të parasë dhe kontrollet janë kryer ashtu siç kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

3.7.3 Trajtimi i të arkëtueshmeve

Komuna nuk ka një proces fuqishëm për identifikimin, regjistrimin dhe monitorimin e faturave të lëshuara për taksat e saj.

Çështja 16 - Vjetërsia e llogarive të arkëtueshme - Prioriteti i lartë

Gjetje Komuna nuk ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për të mbledhur kerkesat dhe nuk ka kryer analiza për vjetërsinë e tyre. Pothuajse 90% e të arkëtueshmeve të tatimit në pronë janë të viteve më herët se 2015.

Risk Mungesa e kontrolleve të mjaftueshme mbi arkëtimin e të hyrave dhe e informacionit për vjetërsinë e shumave të arkëtueshme ndikon negativisht mbi mbledhjen e të hyrave dhe si rezultat edhe mbi fondet që Komuna gjeneron për të mbuluar shpenzimet dhe investimet e saj. Këto mungesa pengojnë identifikimin e problemeve, monitorimin dhe përqendrimin e burimeve të duhura në arkëtimin e të hyrave, dhe prezantimin në PFV të shumave të sakta dhe të plota që pritet të mblidhen.

Rekomandimi 18 Kryetari i Komunës duhet të sigurohet se Komuna ndërmerr hapa dhe të hartoj një plan të detajuar lidhur më arkëtimin e borxheve të vjetra.

3.7.4 Trajtimi i borxheve

Balanca e borxheve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2015 është 195 mijë euro. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2016.

Çështja 17 - Borxhet e papaguara- Prioriteti i lartë

- Gjetje** Komuna nuk ka kryer pagesat e detyrimeve e saj brenda 30 ditësh, siç kërkohet me Rregulloren 01-2013 "Shpenzimi i parasë publike". Nga faturat që arrijnë shumën totale prej 195 mijë euro të prezantuara në pasqyrat financiare, pjesa më e madhe janë fatura të papaguara për më shumë se 30 ditë. Për më tepër, ne kemi identifikuar shumën prej 27 mijë euro të detyrimeve që kanë ndodhur pas datës 31 dhjetor 2015 dhe janë prezantuar si detyrime të papaguara më 31 dhjetor 2015.
- Risku** Si pasojë e vonesave në pagesa dhe mungesës së informacioneve të plota mund të dobësohet aftësia e Komunës për të parashikuar dhe menaxhuar nevojat për likuiditet, poashtu Komuna mund të përballet me kosto shtesë të interesave e gjobave, të kërkuara nga palët e treta.
- Rekomandimi 19** Kryetari duhet të sigurojë që Komuna të ndërmarrë hapa të mëtutjeshëm dhe të zhvilloj plane veprimi për të bërë pagesat brenda periudhës së kërkuar.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe atyre që janë të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në detaje në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultati kryesor i punës sonë është opinionin e auditimit, raporti pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë në çështjet e qeverisjes, duke përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë bazuar në risk.

Përmbledhja Ekzekutive ka për qëllim të nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kryesore për të cilat Kryetari duhet të sigurojë se ata janë marrë me adresimin e dobësive të identifikuara të menaxhimit dhe kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut për të gjeturat e auditimit dhe jep rekomandimet e duhura për t'i adresuar ato. Për plotësinë ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ishin relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Ne kemi marrë parasysh shkallën në të cilën kontrollet menaxheriale mund të mbështeten gjatë përcaktimit të testeve të përgjithshme për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmimeve në mënyrë që të mbështesin opinionin tonë të auditimit. Aktivitetet e Menaxhmentit gjithashtu përcaktojnë fokusin e auditimit tonë të pajtueshmërisë dhe të auditimit të qeverisjes së mirë të cilat nuk do të ndikojnë direkt në opinion.

Qasja jonë e auditimit të qeverisjes është përqendruar në vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti për të siguruar menaxhim financiar dhe kontroll efektiv dhe rezultatet e këtij veprimi në mënyrë efektive në dhënien e rezultateve operative me cilësi të lartë. Për sisteme individuale financiare, ne kërkojmë të identifikojmë nivelin në të cilin operojnë kontrollet aktuale. Ky mund të jetë, për shembull, aktiviteti monitorues i ndërmarrë nga menaxhmenti i lartë apo një kontrollë operative e nivelit më të ulët. Ne shqyrtojmë nëse kontrollet janë të dizajnuara mirë, janë zbatuar siç është planifikuar dhe funksionojnë në mënyrë efektive. Kjo kërkon një vlerësim të strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti, duke përfshirë rolin e ndërmarrë nga Auditimi i Brendshëm dhe Komitetet e Auditimit, si dhe kontrolleve të sistemit egzistues.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Një vlerësim i mënyrës se si Menaxhmenti ka adresuar rekomandimet e bëra në raportin e vitit 2014 mund të shihet në Shtojcën III.

Të gjeturat tona janë definuar si:

Prioritet i lartë - çështje të cilat mund të rezultojnë në një dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi do të ofrojë potencialin për përmirësime në efikasitet dhe efektivitet të kontrolleve të brendshme, si dhe çështjet që mund të ketë ndikim në humbjet ose zotimit të të hyrave; dhe

Prioritet i mesëm - çështjet të cilat nuk mund të rezultojnë në një dobësi materiale, por ku veprimi do të ofrojë potencialin për përmirësime në efikasitet dhe efektivitet të kontrolleve të brendshme.

Gjetjet që konsiderohen me prioritet të ulët do të raportohen veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit shoqëruar me testimin material vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo të gjitha përmirësimet që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara

(e shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për ‘Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit’.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit.

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit - d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar** nëse: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomali, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat

financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë mohim të opinionit nëse, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të prezantuar ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të prezantuar ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në cilën pjesë
Të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është kualifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë prezantuar ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III:Rekomandimet e vitit paraprak

| Numri i Rekomandimit | Komponenti i Auditimit | Rekomandimet e dhëna | Të implementuara | Të adresuara por jo të implementuara | Të pa adresuara |
|----------------------|--|--|------------------|--------------------------------------|-----------------|
| Rekomandimi 1 | Investimet e bëra nga agjencitë tjera qeveritare - | Kryetari duhet të analizojë arsyet për mangësitë e përshkruara lidhur me dokumentet e pronësisë të cilat formojnë një nga pikat për kualifikimin e opinionit dhe të identifikojë veprimin e duhur për t'i adresuar këto dobësi të kontrolleve në mënyrë që të mundësojë një prezantim të drejtë dhe të vërtetë të pasurive në vitin 2015. | | E adresuar por jo e implementuar | |
| Rekomandimi 2 | Pagesat nga palët e treta. | Edhe pse procedura jonë e auditimit nuk hasi në ndonjë të gjetur në lidhje me paraqitjen e pagesave nga palët e treta për vitin 2014, ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se Komuna në mënyrë të vazhdueshme regjistron dhe prezanton në pasqyrat e saj financiare të gjitha pagesat e mundshme nga palët e treta, si edhe barazon informatat nga të gjitha burimet e përfshira në financimin e pasurive. Po ashtu ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se Komuna po bënë përpjekjet maksimale për sigurimin e të dhënave nga palët e treta, me theks të veçantë tek ato palë që dihet se kanë kryer investime të rëndësishme në Komunë. Të dhënat e siguruara duhet të paraqiten drejt në regjistrin e pasurive të Komunës. Praktika e mirë do kërkonte që në baza vjetore të bëhet barazimi i të dhënave mes palëve të treta dhe Komunës për investimet në Komunë për vitin përkatës. | | E adresuar por jo e implementuar | |
| Rekomandimi 3 | Përgatitja e pasqyrave vjetore financiare | Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që procesi i përgatitjes të PVF-ve plotësisht adreson dobësitë e identifikuara në PNF-të dhe kërkesat e Rregullorës MF-Nr. 03/2013. Deklarata e bërë nga Kryetari dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur draft PVF-të dorëzohen në Qeveri duhet të nënshkruhen vetëm pas një shqyrtimi gjithëpërfshirës nga ana e menaxhmentit në lidhje me përmbajtjen dhe saktësinë e PVF-ve. | | E adresuar por jo e implementuar | |

| Numri i Rekomandimit | Komponenti i Auditimit | Rekomandimet e dhëna | Të implementuara | Të adresuara por jo të implementuara | Të pa adresuara |
|----------------------|--|---|------------------|--|-------------------------------------|
| Rekomandimi 4 | Pajtueshmëria me Pasqyrat Vjetore Financiare | Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që procesi i përgatitjes të PVF-ve plotësisht adreson kërkesat e Rregullores MF- Nr. 03/2013. Deklarata e bërë nga Kryetari dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur draft PVF-të dorëzohen në Qeveri duhet të nënshkruhen vetëm pas një shqyrtimi gjithëpërfshirës nga ana e menaxhmentit në lidhje me përmbajtjen dhe saktësinë e PVF-ve. | | E adresuar por jo e implementuar | |
| Rekomandimi 5 | Rekomandimet e vitit paraparak | Kryetari duhet të sigurojë një plan të veprimit, të rishikuar, për adresimin e rekomandimeve të mbetura të vitit 2013 dhe ato të vitit 2014. Ky plan duhet të përcaktojë qartë një afat të arsyeshëm kohor të implementimit, stafin përgjegjës dhe mënyrën e zbatimit, duke u fokusuar fillimisht në fushat me rëndësi të madhe dhe aty ku janë identifikuar dobësi domethënëse. Progresi kundrejt planit duhet të monitorohet direkt nga ana e Kryetarit të Komunës. | | E adresuar por jo e implementuar | |
| Rekomandimi 6 | Kontrollet menaxheriale | Kryetari duhet t'i rishikojë masat ekzistuese të qeverisjes së përgjithshme dhe cilësinë e raportimeve të brendshme të Komunës. Kërkesat e pazbatuara duhet të adresohen deri në fund të vitit 2015. Cilësia e raportimeve dhe mbikëqyrjes buxhetore duhet të rishikohet në mënyrë kritike dhe sistematike për të siguruar arritjen e objektivave të Komunës. | | E adresuar por jo e implementuar | |
| Rekomandimi 7 | Integrimi i çmimeve në sistem | Kryetari i Komunës duhet të siguroj vendosjen e çmimeve për të gjitha shërbimet në sistem me qasje për ndryshime vetëm nga udhëheqësi i drejtoratit ose personat tjerë kompetent. | | | Nuk është adresuar dhe implementuar |
| Rekomandimi 8 | Tatimi në pronë | Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurojë që anketimet dhe kushtëzimet për ofrimin e shërbimeve të bëhen siç kërkohet nga Udhëzimi Administrativ Nr.03/2011. | | Komuna ka filluar të mos ofroj asnjë lloj të shërbimeve komunale pa vërtetimin se pala ka kryer obligimet mbi tatimin në pronë,por | |

| Numri i Rekomandimit | Komponenti i Auditimit | Rekomandimet e dhëna | Të implementuara | Të adresuara por jo të implementuara | Të pa adresuara |
|-----------------------|--|---|--------------------|--|-------------------------------------|
| | | | | Komuna nuk ka kryer të gjitha ankëtimet ashtu siç kërkohet me Udhëzimin Admistrativ. | |
| Rekomandimi 9 | Shpenzimet-Prokurimi | Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se do të bëhet një rishikim i të gjeturave të auditimit në të cilat proceset nuk janë aplikuar në mënyrë efektive, si dhe ta përcaktojë se pse kanë ndodhur dështimet në to. Veprimet/proceset e duhura duhet të implementohen për të siguruar se mangësitë e tilla nuk do të ndodhin në të ardhmen. | | | Nuk është adresuar dhe implementuar |
| Rekomandimi 10 | Kompensimet (pagat dhe mëditjet) | Kryetari duhet të ndërmarrë masa në lidhje me rishikimin sistematik të dosjeve të personelit, për të siguruar se i tërë dokumentacioni i nevojshëm është përfshirë brenda në dosje. | | | Nuk është adresuar dhe implementuar |
| Rekomandimi 11 | Llogaritja e ndalesave për pushimet e lehonisë | Kryetari duhet të sigurojë se kjo çështje do të merret tutje në konsideratë nga administrata e Payroll-it, në mënyrë që të mos lejojë dëmtimin e buxhetit të Komunës. Kryetari duhet të adresojë këtë çështje tek MAP-i që të bëhet ndryshimi në pagën bazë nëpajtueshmëri me vendimet e qeverisë dhe ndryshimet të reflektohen në sistemin e pagave tek arsimi para universitar. | Është implementuar | | |
| Rekomandimi 12 | Subvencione dhe transfere- | Kryetari duhet të sigurojë që të gjitha shpenzimet e Komunës duhet të dokumentohen në mënyrën e duhur. | Është implementuar | | |
| Rekomandimi 13 | Inventarizimi i pasurive kapitale | Inventarizimi i pasurive kapitaleKryetari duhet të sigurohet që inventarizimi i pasurive jo financiare është kryer në përputhje me rregulloren në fuqi për pasuritë jo financiare të organizatave buxhetore dhe të sigurohet që inventarizimi të kryhet në baza vjetore. | | E adresuar por jo e implementuar . | |

| Numri i Rekomandimit | Komponenti i Auditimit | Rekomandimet e dhëna | Të implementuara | Të adresuara por jo të implementuara | Të pa adresuara |
|-----------------------|---|--|------------------|--------------------------------------|-------------------------------------|
| Rekomandimi 14 | Regjistri i pasurive kapitale | Kryetari duhet të sigurohet që regjistri i pasurive kapitale në regjistër të përmbajë të gjitha informatat e nevojshme si: datën dhe vitin e blerjes, datën kur pasuria është vënë në funksion në mënyrë që të mund të bëhet përlllogaritja e saktë e zhvlerësimit. Për më tepër kryetari duhet të sigurohet që të gjitha pasuritë kapitale të regjistruara janë të sakta dhe të plota | | E adresuar por jo e implementuar . | |
| Rekomandimi 15 | Shpalosja e pasurive kapitale me vlerë nën 1,000 Euro | Kryetari duhet të sigurohet që regjistri i pasurive kapitale në regjistër të përmbajë të gjitha informatat e nevojshme si: datën dhe vitin e blerjes, datën kur pasuria është vënë në funksion në mënyrë që të mund të bëhet përlllogaritja e saktë e zhvlerësimit. Për më tepër Kryetari duhet të sigurohet që të gjitha pasuritë kapitale të regjistruara janë të sakta dhe të plota. | | E adresuar por jo e implementuar . | |
| Rekomandimi 16 | Vjetërsia e të arkëtueshmeve | Kryetari i Komunës duhet të sigurohet se Komuna ndërmerr hapa të mëtejshëm për përmirësimin e kontrolleve në arkëtimin e të hyrave .Prioriteti i arkëtimin duhet të fokusohet kundrejt borxheve të vjetra. Zyra Komunale në bashkëveprim me Departamentin e Tatimit në Pronë duhet të sigurohen që tatim paguesve të ju dërgohen vërejtjet për pagesën e tatimit siç kërkohet me Udhëzimin Administrativ Nr. 08/2011 “Për vjeljen e tatimit në pronën e paluajtshme” ose edhe të arritën marrëveshje me tatimpaguesin për pagesën e tatimit në pjesë.. | | E adresuar por jo e implementuar | |
| Rekomandimi 17 | Trajtimi i borxheve | Kryetari i Komunës të sigurohet se Komuna do të ndërmarrë hapa të mëtejshëm dhe të hartojë plane veprimi për të kryer pagesat brenda periudhës së kërkuar. | | | Nuk është adresuar dhe implementuar |
| Rekomandimi 18 | Sistemi i auditimit të brendshëm | Kryetari i Komunës duhet të sigurojë burime të mjaftueshme njerëzore për këtë njësi si dhe të bëjë një Plan Veprimi që duhet të zbatohet për të siguruar adresimin e këshillave të rezultuara.ërmëshja e aktiviteteve të planifikuara të auditimit duhet të monitorohet mbi një bazë të rregullt kohore dhe të ndërmerren veprime proaktive, në mënyrë që devijimet të adresohen në kohën e duhur.. | | | Nuk është adresuar dhe implementuar |

Shtojca IV: Përgjigja e Menaxhmentit ndaj të gjeturave tona të auditimit të vitit 2015

| Të gjeturat | Pajtohemi po/jo | Komentet nga Komuna në rast të mospajtitimit | Pikëpamja e auditorit |
|----------------|-----------------|---|-------------------------------|
| Rekomandimi 1: | Pjesërisht | Është bërë analizë detale per opinionin nga viti i kaluar dhe per këtë komuna ka marrë veprime per te gjeturat e përshkruara sipas auditorit per te cilat komuna paraprakisht nuk është pajtuar plotësisht . | Gjetjet e auditorit qëndrojnë |
| Rekomandimi 2: | Jo | Ka pajtueshmëri te plotë rregullative te PVF 2015 dhe ka pasur shqyrtim gjithëpërfshirës te menaxhmetit per sakesin dhe përmbajtjen e tyre | Gjetjet e auditorit qëndrojnë |
| E gjetura 1: | Jo | Komuna ka formuluar nje plan veprimi per eliminimin e rekomandimeve nga viti i kaluar përmes nje procesi te monitorimit te vazhdueshëm dhe ka eliminuar pothuaj se te gjitha kërkesat nga auditimi per vitin 2014. Plani ka paraparë kalendarin kohor te zbatimit , personat përgjegjës dhe mënyrën e zbatimit. Plani ishte dorëzuar ne ZAP kurse kopjen e kishit edhe ju ne dispozicion. | Gjetjet e auditorit qëndrojnë |
| E gjetura 2: | Jo | Komuna pyetësorin per vetëvlerësim e ka plotësuar me shumë kujdes dhe është përgjigjur ashtu siç e ke kryer edhe funksionin e saj | Gjetjet e auditorit qëndrojnë |
| E gjetura 3: | Jo | Te gjithë drejtorët e drejtorive raportojnë ne baza javore dhe me kohë intervenohet ne parandalimin e riskut | Gjetjet e auditorit qëndrojnë |
| E gjetura 4: | Jo | Menaxhimi i riskut është i deleguar të çdo drejtor | Gjetjet e auditorit qëndrojnë |
| E gjetura 5: | Jo | Pasqyrat financiare rregullisht përgatiten sipas | Gjetjet e auditorit qëndrojnë |

| | | | |
|--------------|------------|---|-------------------------------|
| | | Rregullës financiare ne fuqi 06/2011 per raportim nëntëmujor , gjithashtu komuna përgatiti edhe raporte tremujore siç kërkohet me nenin 45.4 te LMFPF | |
| E gjetura 6: | Po | Në të ardhmen do të vepohet siaps rekomandimit, | |
| E gjetura 7: | Pjeserisht | Planifikim mjaft optimist nga MF qe po e obligon komunën te planifikoj te hyra vetanake përtej mundësive të saj ka qar deri tek shkurtime e të hyrave te parapara per financimin e projekteve kapitale | Gjetjet e auditorit qëndrojnë |
| E gjetura 8: | | <p>Ne faqen 25 renditja e pare eshte cekur se ka munguar deklarata e nevojave dhe percaktimit te fondeve , kjo eshte nje qeshtje teknike sepse asnje tender nuk mund te shpallet pa u bere planifikimi I projekteve do te thote te kodeve buxhetore , dhe te gjitha keto projekte kane qene te perfshira edhe ne planifikimin qe eshte derguar ne AQP ne Prishtine dhe keto projekte jane votuar ne Kuvendin Komunal nga Deputete e Kuvendit komunal qe eshte si rregull dhe mendoj se kur te aprohet buxheti nuk eshte fort shume e rendesisheme a eshte zotuar ne ditën e pare apo me vone e rendesisheme eshte se kane qene te planifikuara .</p> <p>Ne renditjen e dyte ceket se zotimi I mjeteve ka qene me pak se shuma e kontratave te nenshkruara ne baze te ligjit te prokurimit public 04/L042 lejohet qe te zhvillohen kontratat Kornize ne periudhen dy vjeqare apo 3 vjeqare mirpo gjithnje duke e planifikuar buxhetin per cdo vit per projektet e zhivllura .Ne si Komune ne shume raste kemi marraveshje apo Memorandume me Ministrite per bashkefinancimin dhe ne marreveshje ceket per projektin ne fjale sa % ne kete vit financohet sa ne vitin tjeter dhe nuk ka asnje shkelje sa I perket</p> | Gjetjet e auditorit qëndrojnë |

| | | | |
|--|--|--|--|
| | | <p>zotimit te mjeteve .</p> <p>Ne 5 raste ceket se siguria e ekzekutimit te tenderit nuk e mbulon te gjithë periudhen e Kontrates .Ne keto 5 raste siguria e ekzekutimit 10% ekziston per nje vit me mundesi vazhdimi prap per vitin tjetër dhe ne si Autoritet kontraktues nuk lejojme asnje pagese per tu bere pa sigurimin e ekzekutimit . Mirpo nuk do te thote se per kete shkelje sepse siguria e ekzekutimit ka qene dhe mund te behet prap edhe per periudhen 1 vjeqare dhe dy vjeqare .</p> <p>Ne nje rast te prokurimit ne vlere 465, 000 Euro keni verejtur se nuk ka zotim te mjeteve ne kete rast nuk po mundemi me e dite per cilin projekt eshte fjala sepse mungon nr. identifikues I prokurimit ne te gjitha rastet dhe ne te gjitha rastet e Auditorit qe ka bere auditimin e lendeve mungon nr. identifikues I prokurimeve dhe kete menyre ma veshterson edhe punen per ti kthyer komentet e mia si zyrtar pergjegjes I prokurimit .</p> <p>Kurse sa I perket zotimit te mjeteve nuk eshte e veretete se nuk ka pasur zotim te mjeteve sepse asnje projekt nuk mund ta zhvillojme pa proceduren e prokurimit , pa qene e planifikuar ne buxhet dhe pa e pas kodin buxhet dhe pa u aprovuar asambjeja komunale nga Deputet e Kuvendit komunal prandaj , kjo eshte rregull qe duhet te kaloje neper keto procedura .</p> <p>Ne nje rast te prokurimit ne vleren prej 389,000.00 Euro ceket se jane bere fatura te parregulla .Une si zyrtar I prokurimit nuk po e kuptoj se qka eshte fatura e parregullt .Mirpo ne nje takim qe keni qene me zyrtaret e zyres se Auditorit dhe me Drejtorin e Financave u cek edhe kjo pike .Shpjegimi I auditoreve do te thote I zyrtareve ka qene se</p> | |
|--|--|--|--|

| | | | |
|--|--|---|--|
| | | <p>mungon ne kete pagese nr. fiskal I Operatorit ekonomik NN."Bislimi " kurse une zyrtari pergjegjes I prokurimit e kam spjeguar se zyrtarja e Free Balance qe e ben nxjerrjen e urdherblerjeve te ne e rendesishme eshte nr. I biznesit dhe pa nr. te biz. Nuk mund te njerret urdhereblerja , kurse pa nr. fiskal mundet .Nderkaq nr. fiskal vlen me shume per evidencave qe I mban Ministria per ekonomi dhe Financa prandaj sa I perket verejtejes qe I keni bere analizoni vet se a u dashte te shenohet apo jo .</p> <p>Ne nje rast te prokurimit keni cekur se : Komuna ka nenshkruar nje Memorandum me Ministrine e Financave ne vlere prej 600, 000.00 euro . Komuna nuk e ka nenshkruar Memomarandumin me Ministrine e Financave Por , e ka nenshkruar Memorandumin MAPH per "Ndertimin e Kanalizimit ne Runik " .Ne kete Memorandum qe eshte nenshkruar ne mes te MAPH dhe Komunes ne kete Marreveshje ka qene edhe participimi I Komunes me 12 % te projektit .Ne si Komune kemi participuar me vetem 20,000.00 euro . Nderkaq pjesen tejter e ka marre persiper MHPH ne Shumen prej 600, 000.00 euro kurse gjate fazes se prokurimit kemi perzgjedhur OE I cili ka qene me qmimi me I liri dhe I ka plotesuar te gjitha kushtet dhe kriteret e kerkuara dhe me qmim prej 526,000.00 euro .Ne si zyre e prokurimit nga procedurat e zhvilluara dhe nga konkurenca e krijuar ku kane ofertuar 8 OE , kemi perzgjedhur OE me qmim me te lire nga OE tjere konkurues .Nga Auditori nuk po e kuptoj se qka ka dashte me thene per kete projekt per Shumen e pageses nga Komuna prej 20,000.00 euro kurse ne Memorandum ceket fort mire se edhe Komuna duhet te participoj ne kete projekt , nuk po e kuptoj se qfar vreteje eshte apo leshim .</p> <p>Ne dy raste te prokurimit tek kuotimi I</p> | |
|--|--|---|--|

| | | | |
|--|--|---|--|
| | | <p>qmimeve eshte cekur se kuotimi I qmimeve nuk duhet te jete me pak se pese dite .Sqarimet per keto dy raste nuk kane qene te perfshira , andaj me ardhjen nga kerkesat nga dy drejtorite dhe me deklaraten e nevojave dhe percaktimit te disponueshmerise se fondeve e kemi filluar proceduren e prokurimit dhe e kemi derguar ne AQP dhe kemi marre aprovimin dhe kemi filluar me proceduren e kuotimin e qmimeve ku ka mundur me u leshuar ndonje gabim ne afatin e kerkuar .</p> <p>Ne nje rast te prokurimit ne vlere prej 40,000.00 Euro per Furnizimin me automjete zyrtare per Komunen e Skenderajt japim sqarime se ky furnizim ka qene edhe ne Planifikimin vjetor dhe ne buxhet , ku mund te shihet edhe nga ju ne planifikimin e prokurimit per vitin 2015 do te thote kete Planifikimin te Prokurimit e keni edhe ne web faqen e AQP-se dhe Planifikimin e Prokurimit e keni marre fizikisht nga ana e Prokurimit , ku ne faqen e dyte ne nr. rendor 29 shihet se eshte Furizimi me automjete per Komunen e Skenderajt .</p> <p>Ne nje rast te prokurimit ne vlere prej 20,000.00 euro ,keni spjeguar se ka munguar Sigurimi I ekzekutimit te tenderit nuk eshte ne vleren 10 % , te kontrates dhe sqaroj: une nuk e di se ka munguar sigurimi I ekzekutimit ne kete rast .</p> <p>Ne nje rast te prokurimit ne vleren prej 5500.00 euro keni cekur se mareveshja nuk ka date te nenshkrimit dhe daten e skadimit , nuk po mund ta kuptoj per qka e keni fjalne sepse nuk e keni cekur nr. e prourimit dhe ka mangesi te informacionit nga pershkrimi I raportit .</p> <p>Ne nje rast te prokurimit ne vlere prej 45,000 euro ju keni verejtur nje mosperputhje ne mes te fatures , fletedergeses dhe raportit mbi pranimin e</p> | |
|--|--|---|--|

| | | | |
|--------------|----|--|--|
| | | <p>mallit .Mundet me qene ndonje gabim teknik se perndryshe asnje fature apo malle nuk mund te behet pagesa pa kaluar neper komisione te pranimit te mallit dhe pa pas vendim te komisionit te pranimit te mallit .</p> <p>Ne dy raste te procedurave te prokurimit qe perfshijne vleren ne total prej 16,000 .00 euro keni verejtur se mungon Garantimi I puneve siq eshte cekur ne Kontrate dhe saqaroj : Dhe nga punet e shumta voluminoze qe I kemi ne zyre eshte bere ky lshim , mirpo ne keto dy raste I kemi pranimet teknike nga Komisionet qe tregon se eshte kryer puna ne menyre profesionale dhe te pergjegjeshme nga ana Operatorit ekonomik .</p> <p>Ne nje rast te prokurimit ne vleren prej 10,000 .00 euro keni cekur se3 OE ka faturuar nje produkt te sherbimit te cilat nuk jane ne listen e ofertes te dosjen se tenderit .Sqaroj ne kete rast ne baze te procedurave te prokurimit qe I kemi zhvilluar per mirembajtejen e kompjutereve , printereve ka qene me procedure te hapur , dhe ne nje rast kemi pasur kuotim te qmimeve per kompjutera dhe I njeiti Operator ekonomik e ka fituar edhe kete tender dhe ka mund qe ti shtin nje produkt te sherbimit ne kete rast ku edhe qmimi I ketij produkti ka qene ne vlere prej 6 euro .</p> <p>Ne nje rast te prokurimit ne vlere prej 45,000.00 euro keni verejtur qe ne Deklarata e nevojave dhe Disponueshmerise se Fondeve neni 3 ne Rishikim nuk eshte nenshkruar nga Zyrtari Kryesor Financiar , sqaroj : Ky eshte nje leshim qe nuk ndikon ne procedure ne te ardhmen nuk do te ndodhe .</p> | |
| E gjetura 9: | Po | Po vepohet sipas rekomandimit | |

| | | | |
|---------------|------------|---|-------------------------------|
| E gjetura 10: | Pjesërisht | Komuna ka rishikuar dhe ndjekë vlerën e drejtë të pronave që janë në juridiksionin e saj çdo tre deri në pesë vjet. Raporti ne vitet e kaluara është pargaditur nga Komuna për përcaktimin e vlerës së drejtë të pronës së paluajtshme në përputhshmeri më udhëzimin administrative nr 04/2011. Ne kete vit me buxhet komuna ka planifikuar blerjen e një suouftveri per kontabilitetitin e te hyrave vetanake per te gjitha drejtoritë | Gjetjet e auditorit qëndrojnë |
| E gjetura 11: | Jo | Komuna ka regjistruar pasurit mbi 1000€ me te gjitha te dhënat qe kërkon sistemi i "Free Ballace"-it , kurse regjistrimet nga palët tjera janë regjistruar ne bazë te dhënave qe i kanë dërguar palët sipas kërkesave te komunës dhe janë vendosur ne sistem ashtu siç kërkohet edhe me nenin nr. 12 dhe 13 te Rregullores Nr. 02/2013 | Gjetjet e auditorit qëndrojnë |
| E gjetura 12: | Pjesërisht | Komuna ka bërë inventarizimin e rregullt vjetore dhe per këtë ka bërë edhe procesin e komisionit komunal per numrimin fizik te pasurisë komunale | Gjetjet e auditorit qëndrojnë |
| E gjetura 13: | Pjesërisht | Komuna nuk ka përdorur sistemin "E-pasuri" por ka përdorur nje sistem alternativ per regjistrimin e pasurisë nen 1000€ dhe ekipit i ka ofruar informacione rreth tyre dhe barazimeve te tyre te cilët nuk kanë pasur ndonjë vërejte per to! | Gjetjet e auditorit qëndrojnë |
| E gjetura 14: | Pjesërisht | Komuna rregullisht bën përpjekje per sigurimin e te dhënave nga palët tjera(III-ta) qe kryejnë investime per interes te komunës dhe deri me tani kemi siguruar vetëm dokumentacionin mbështetës per regjistrim te pasurisë ne sistem. Kurse bartja e pronësisë nuk ka ndodhur ende, por këto pasuri evidentohen si investime ne vijim ashtu siç kërkohet edhe me Rregulloren Nr. 02/2013 neni 12 dhe 13 i saj. | |

| | | | |
|---------------|------------|---|-------------------------------|
| E gjetura 15: | Jo | Parat dorëzohen rregullisht në bankë ashtu siç është paraparë me legjislacionin në fuqi edhe me procedurat komunale. | Gjetjet e auditorit qëndrojnë |
| E gjetura 16: | Pjesërisht | Komuna është duke respektuar afatin kohor të ligjit për faljen e borxheve, ndërsa pas këtij afati do të ndermërrin masa ligjore për të gjithë obliguesit e vjetër, duke shkuar edhe përmes përmarrësve privat si masë e fundit. | Gjetjet e auditorit qëndrojnë |
| E gjetura 17: | Pjesërisht | Komuna në të ardhmen do të veprojë në tërësi sipas rekomandimit | Gjetjet e auditorit qëndrojnë |

Shtojca V: Pasqyrat Vjetore Financiare

